



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 243/18

Nr. i fq. / No. of

Data: / Datum 20.02.2018

VUSHTRRI - VUÇITRN



Komuna Vushtri

## MEMORANDUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI

në mes të

**Aleancës Kosovare të Bizneseve dhe Komunës së Vushtrrisë**

### 1. QËLLIMI

1.1. Nënshkrimi i këtij memorandumi ka për qëllim që palët nënshkruese të bashkëpunojnë si partnerë në: udhëzimin, mbështetjen dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik në qytetin e Vushtrrisë përmes:

- 1.1.1 17 Qershor – “Dita e Çlirimit të Vushtrrisë” – Panairit të prodhimeve vendore me moto < Unë konsumoj produkte vendore, Po JU?>.
- 1.1.2 Promovimit të ekonomisë lokale në tregun lokal dhe ndërkombëtar.
- 1.1.3 Avokimit dhe lobimit të AKB-së për binjakëzimin e Komunës së Vushtrrisë me ndonjë komunë të vendeve të BE-së.
- 1.1.4 Propozimit për investime të reja në Vushtri, nga kompanitë e huaja të interesuara.
- 1.1.5 Projekt-propozimit për elektrifikim të hapësirës publike në qytet me ndriçim LED.
- 1.1.6 Promovimit efikas të bizneseve, investimeve dhe të konkurrencës në treg.
- 1.1.7 Shtytjes së zhvillimit ekonomik regjional dhe rigjenerimit të punësimit.
- 1.1.8 Promovimit të punësimit, ngritjes së edukimit dhe të aftësisë profesionale në fushat relevante ekonomike.
- 1.1.9 Kontributit për arritjen e qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik lokal.
- 1.1.10 Realizimit të projekteve me interes për ekonomi në qytetin e Vushtrrisë.

1.2. Qëllimi themelor i këtij memorandumi është thëllimi i bashkëpunimit në fushën e mbështetjes të çështjeve të zhvillimit ekonomik në regjion;

1.3. Promovimi i krijimit të vendeve të punës, zhvillimi i teknologjisë dhe resurseve njerëzore;

1.4. Krijimi i ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, si dhe atraktivitetin të investimeve lokale, regjionale dhe ndërkombëtare;

1.5. Mbështetja e zhvillimit të biznesit lokal, regjional;

1.6. Zhvillimi i partneritetit të sektorit publiko - privat me bizneset në regjion.

## **2. PARTNERËT PAJTOHEN PËR KËTO ÇËSHTJE**

2.1. Ky memorandum i mirëkuptimit i rregullon format dhe kushtet për bashkëpunim në mes të Aleancës Kosovare të Biznesit, Komunës së Vushtrrisë në realizimin e synimit të përbashkët në: promovimin efikas të bizneseve, mbështetje të ngjarjeve biznesore, edukim dhe aftësim profesional, investime, konkurrencë në treg, konkurrencë në projekte apo fonde të ndryshme financiare, shtytje të zhvillimit ekonomik regjional dhe regjenerim të punësimit, promovim të punësimit dhe ngritjes së aftësimit profesional në fushat relevante ekonomike, shtytje për arritjen e qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik lokal, ku më pas do të matet shkalla e bashkëpunimit nga palët nënshkruese, në takimet e përbashkëta që do të trajtojnë bashkëpunim në fushat e veçanta.

2.2. Bashkëpunimi i cekur në paragrafin e mëparshëm do të realizohet mbi bazat e interesit reciprok.

## **3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE**

### **3.1. Detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve sipas Memorandumit të Mirëkuptimit**

Ky memorandum i mirëkuptimit synon rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve në procesin e implementimit të qëllimeve të përshkruara në pikën 1.1.

### **3.2. Përgjegjësitë e Aleancës Kosovare të Bizneseve do të zhvillojë bashkëpunim në realizimin e:**

3.2.1 promovimit të prodhimeve vendore “Java e biznesit kosovar”;

3.2.2 promovimit të bizneseve, investimeve, teknologjisë;

3.2.3 propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik lokal;

3.2.4 propozimeve lidhur me planifikimin e edukimit dhe aftësimit profesional;

3.2.5 zhvillimit të projekteve të përbashkëta në ekonomi, dhe

3.2.6 angazhimit në aktivitetet tjera ekonomike.

3.2.7 Kolegji Universum ofron mundësin e ndarjes së 5 bursave 3 bachelor dhe 2 master për studentët e komunës së Vushtrrisë. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga Komuna e Vushtrrisë.

### **3.3. Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë**

3.3.1. Do të ofrojë bashkëpunim të mirëfilltë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike që do të zhvillohen në Komunën e Vushtrrisë, duke mbështetur projektin për promovimin e prodhimeve vendore;

3.3.2. Do të ofrojë bashkëpunim të mirëfilltë në zhvillimin e projekteve tjera me karakter ekonomik;

3.3.3 Do të angazhohet që të siguroj hapësirë të nevojshme për zyrë për takime me bizneset e komunës;

3.3.4. Do të mbajë takime të përbashkëta zyrtare, sipas nevojave të palëve;

3.3.5. Të sigurojë hapësirën e sheshit për panair, foltoren, zërimin dhe kompanitë lokale;

3.3.6. Të ofrojë kërkesa teknike që AKB-së i nevojiten për aktivitetet ekonomike të lartcekura;

3.3.7. Të caktojë personin përgjegjës nga Komuna e Vushtrrisë si pikë kontakti për AKB.

#### **4. ÇËSHTJET TJERA TË BASHKËPUNIMIT**

4. 1. Palët në interes do të zhvillojnë bashkëpunimin për mbështetjen e të gjitha aktiviteteve, të cilat kanë për qëllim zhvillimin ekonomik lokal. Do të synohet që të ndërtohet një bashkëpunim dhe koordinim i vazhdueshëm e afatgjatë i këtyre aktiviteteve;
4. 2. Palët gjithashtu ndihmohen që të veprojnë reciprokisht në realizimin e këtij memorandumi të mirëkuptimit.

#### **5. RREGULLAT DHE INSTRUKSIONET**

- 5.1. Ndryshimi eventual i ndonjë dispozite të këtij memorandumi të mirëkuptimit, mund të bëhet me pëlqimin e palëve (me shkrim), të nënshkruar nga personat e autorizuar;
- 5.2. Anekset e këtij memorandumi të mirëkuptimit mund të shtohen dhe hiqen nëpërmjet “marrëveshjes reciproke” për fushat operationale, respektivisht procedurat përkatëse dhe të njëjtat mund të nënshkruhen.

#### **6. PRIVILEGJET DHE IMUNITETI**

Gjithçka që përmban ky memorandum i mirëkuptimit do të konsiderohet si dokument i të gjitha privilegjeve dhe imuniteteve, që është e drejtë e dy palëve.

#### **7. MOSPAJTIMET DHE PAQARTËSITË**

Nëse gjatë zbatimit të këtij memorandumi të mirëkuptimit paraqiten paqartësi, mospajtimet në mes të palëve nënshkruese apo ndonjë ankesë, do të zgjidhen përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe në frymën e marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit të ndërsjellë.

#### **8. KOHËZGJATJA**

Ky memorandum i mirëkuptimit do të jetë valid dhe i plotfuqishëm, përderisa të gjitha obligimet do të përmbushen nga të dy palët.

#### **9. VLEFSHMËRIA**

- 9.1. Ky memorandum i mirëkuptimit do të fitojë vlefshmërinë në rastin e nënshkrimit nga zyrtarët e të dy palëve. Mund të jete i vlefshëm përderisa ndonjëra nga palët nuk kërkon që e njëjta të ndryshohet apo ndërpritet;
- 9.2. Ndryshimet në të, apo ndërprerja mund të bëhet me paralajmërim me shkrim në mes palëve, duke i shqyrtuar të gjithë komponentët për ndryshime apo për ndërprerje.

## 10. HYRJA NË FUQI

10.1. Ky memorandum i mirëkuptimit është përpiluar në pesë (5) kopje dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të partnerëve.

**Data e nënshkrimit:**  
**19.02.2018 Vushtri**

### NËNSHKRUESIT

Z. Agim Shahini



Kryetar i AKB-së



Z. Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

